

# Plani vjetor 2018

*Plani vjetor i Institutit të Statistikave*

## **INSTAT - Instituti i Statistikave**

---

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4  
2233356  
Fax+(355) 4 2228300

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë,  
Shqipëri

[info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)

---

## Përmbajtja

Përmbajtja	2
Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm	3
Objektivat Strategjik	5
Memorandumet e Mirëkuptimit	6
Sistemi Kombëtar Statistikor	8
Cilësia	10
Integrimi Evropian	11
Cens 2020	12
Publikimi dhe Shpërndarja e Statistikave	14
Sistemi i menaxhimit, raportimi dhe kontrollit	16
Struktura organizative	19
Burimet financiare	21
Planet e punës	23
Drejtoria e Llogarive Kombëtare	24
Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real	26
Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit	28
Drejtoria e Statistikave Ekonomike	30
Drejtoria e Statistikave Sociale	32
Drejtoria e Statistikave Rajonale	34
Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit	36
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	38
Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve	40
Kontaktet e institucionit	42

## Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

---

Plani vjetor i INSTAT përcakton prioritetet kryesore për vitin 2018. Plani detajon punët që do të kryhen nga INSTAT gjatë vitit, duke përkrahur punët rutinë dhe ato të reja të planifikuara në kuadër të PSZ, në kuadër të përmirësimit të cilësisë statistikore, rritjes së numrit të burimeve administrative të të dhënave dhe rritjen e numrit të treguesve, gjithmonë me qëllim përafrimin e standardeve me ato të BE.

Tema e planit për vitin 2018 është monitorimi dhe përmirësimi i matjes së performancës së Institutit të Statistikave.

Viti 2018 do të jetë një vit sfidues për INSTAT pasi ka përpara:

1. Miratimin nga Parlamenti i Ligjit të ri për "Statistikat Zyrtare"
2. Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Cens-in e Popullsisë dhe Banesave, 2020
3. Hartimi dhe miratimi i strategjisë për Cens 2020
4. Hartimi i strategjisë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor
5. Implementimi i Kornizës së Matjes së Performancës, PAF
6. Implementimi i Strategjisë 2018-2022
7. Implementimi i Sistemit të Përdorimit të Kohës, SIPK
8. Hartimi i planit për indikatorët e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, SDG
9. Fillimi i punës për Auditimin Statistikor
10. Rritja e numrit të të dhënave administrative dhe regjistrave administrativ nëpërmjet funksionimit të Memorandumeve të nënshkruara në vitin 2017 dhe/apo nënshkrimit të atyre të reja gjatë 2018
11. Funksionimi i Qendrës së Trajnimit dhe implementimi i strategjisë së planit të veprimit të qendrës
12. Rritja e rolit të INSTAT në përfaqësimet në arenën ndërkombëtare
13. Rritja e kontributit të INSTAT në studime me anë të Revistës Shkencore
14. Përmirësimin e cilësisë së treguesve/aktiviteteve
15. Implementimi i aktiviteteve statistikore të reja

Për të arritur outputet e sipër përmendura është hartuar plani operacional në mënyrë që puna të jetë më efiçente duke planifikuar paraprakisht dhe duke u siguruar që kemi burimet e duhura për të arritur qëllimet.

Nuk kam asnjë dyshim se qëllimet e vendosura do të realizohen dhe kam kënaqësinë më të madhe të prezantoj planin operacional të INSTAT



Delina IBRAHIMAJ  
**Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT**

## Objektivat Strategjik

---

Instituti i Statistikave është institucion qendror publik në varësi të Kryeministrit, i specializuar për përgatitjen, mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin, interpretimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore zyrtare të vendit.

INSTAT e ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij. Ai është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare dhe koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS).

Nën cilësinë e përfaqësuesit të Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT synon rritjen e performancës së tij duke ndikuar në përmirësimin e pavarësisë profesionale, imazhit të institucionit statistikor dhe besueshmërisë së publikut në veprimtarinë e tyre dhe statistikat zyrtare që prodhojnë.

Duke qenë prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend si dhe për të përmbushur rolin e koordinatorit të SKS, gjatë vitit 2017, INSTAT hartoi Strategjinë 2018-2030 dhe planin tre vjeçar të veprimit për zbatimin e saj. Objektivat kryesorë strategjikë të institucionit janë:

**Objektivi 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.**

**Objektivi 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.**

**Objektivi 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.**

**Objektivi 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.**

## Memorandumet e Mirëkuptimit

---

Gjatë viteve të fundit vëmendja e EUROSTAT, FMN dhe institucioneve statistikore të vendeve të tjera është orientuar drejt përdorimit të sa më shumë burimeve administrative të të dhënave, të cilat zakonisht janë edhe më pak të kushtueshme. Kjo gjë nuk është lënë jashtë vëmendjes së INSTAT, i cili në vitin 2017 ka nënshkruar 19 Memorandume Mirëkuptimi (MM) në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucione të tjera publike.

Lista e memorandumëve të nënshkruara janë si më poshtë:

1. MM me Qendrën e Kombëtare të Biznesit
2. MM me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
3. MM me Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
4. MM me Agjencinë e Postës dhe Komunikimeve Elektronike
5. MM me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar
6. MM me Shërbimin Social Shtetëror
7. MM me Shërbimin Kombëtar të Punësimit
8. MM me Institutin e Sigurimeve Shoqërore
9. MM me Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë dhe Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit
10. MM me Ministrinë e Kulturës
11. MM me Ministrinë e Mbrojtjes
12. MM me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit
13. MM me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
14. MM me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare
15. MM me Drejtorinë e Burgjeve
16. MM me Universitetin Bujqësor të Tiranës
17. MM me Fakultetin Ekonomik të Tiranës
18. MM me Universitetin e Vlorës
19. MM me Universitetin e Harvard

Për vitin 2018 ka në plan të zhvillojë një sërë marrëveshesh të tjera mirëkuptimi por edhe rishikimin e atyre ekzistuese me institucionet shtetërore në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional. Ndërkohë që puna më e madhe e INSTAT gjatë vitit 2018 do të jetë e përqëndruar në drejtim të përdorimit të të dhëna administrative të kërkuara nga

memorandumet e mësipërme, për përmirësimin e cilësisë, të kohës e raportimit dhe të rritjes së numrit të treguesve të publikuar.

## Sistemi Kombëtar Statistikor

---

### Sistemi Kombëtar Statistikor

Sistemi Kombëtar Statistikor është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilat mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas Programit pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare, dokument i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit.

### Legjislacioni

Sistemi Kombëtar Statistikor është në fazat fillestare të zhvillimit të tij. Për këtë arsye, INSTAT, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e Eurostatit po punon për hartimin e kornizës së plotë ligjore për formalizimin e SKS si institucion dhe mekanizmave të duhura që do të shërbejnë për prodhimin cilësor të statistikave zyrtare, në përputhje me parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

Përkufizimi i Sistemit Kombëtar Statistikor përcaktohet në nenin 2/c të Ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar.

### Koordinimi i SKS

Mbështetur në nenin 7/1 të ligjit të statistikave zyrtare, Instituti i Statistikave është përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e SKS. Veprimtaria koordinuese përfshin kryesisht bashkëpunimin ndërmjet prodhuesve të statistikave zyrtare për të siguruar planifikimin dhe monitorimin më të mirë të treguesve statistikorë, koherencën ndërmjet veprimtarive të secilit institucion dhe reduktimin e kostove të veprimtarive statistikore.

INSTAT është institucioni përfaqësues i SKS pranë sistemit statistikor evropian dhe organizatat ndërkombëtare.

Aktualisht, prodhuesit e statistikave zyrtare janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

### Roli i INSTAT si Koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor



Duke patur parasysh statusin e ri të Shqipërisë si vend kandidat për anëtarësim në BE, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë janë dhënë rekomandime për forcimin e kuadrit ligjor në drejtim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm statistikor dhe forcimin e kompetencave të INSTAT si koordinator i këtij sistemi.

Për vitin 2018 INSTAT do të fokusohet në përgatitjen e dy dokumenteve kryesore:

1. Rishikimin e Ligjit për statistikave zyrtare;
2. Hartimin e strategjisë së zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Projektligji i statistikave është dërguar në Këshillin e Ministrave dhe ndodhet në fazën përfundimtare të diskutimeve me ministritë e linjës. Ai parashikon ndryshimin e statusit juridik të INSTAT si institucion i pavarur, i cili i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Shqipërisë, duke bërë të mundur pozicionimin në një shkallë më të lartë hierarkie në administratën publike, për të siguruar funksionimin e duhur të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Lidhur me hartimin e strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT është në komunikim të vazhdueshëm me qeverinë shqiptare dhe Bankën Botërore për të bërë të mundur nga donator mbështetjen e procesit. Strategjia e zhvillimit të SKS parashikohet të përfundojë brenda vitit 2018.

Në tremujorin e dytë të vitit 2018 është planifikuar vlerësimi i funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor (Peer Review), i cili do të kryhet nga ekspertë vlerësues të Eurostat. Misioni i ekspertëve do të ndihmojë në përgatitjen e një raporti të detajuar mbi nivelin e zbatimit të parimeve statistikore evropiane si dhe të propozojë aktivitete përmirësuese për çdo parim.

Gjithashtu, në përmbushje të strategjisë zhvillimore të institucionit si dhe në përputhje me planin e veprimit për zbatimin e strategjisë, gjatë vitit 2018 INSTAT do të fokusohet edhe në nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me siguresit e të dhënave administrative apo prodhuesit e statistikave zyrtare, rritjen e bashkëpunimit me boten akademike dhe universitetet për rritjen e kapaciteteve profesionale të statisticienëve, hartimin e listës së shërbimeve statistikore që do të ofrojnë prodhuesit e statistikave zyrtare, etj.

## Cilësia

---

### Cilësia Statistikore

Në përputhje me Ligjin e Statistikave, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikatat të jenë sa më të përditësuara. INSTAT ka ofruar Raportet e Cilësisë në nivelin e produkteve statistikore, duke mundësuar deri në vitin 2017 publikimin e 14 raporteve në faqen e web-it dhe në vitin 2018 publikimin e 19 raporteve gjithsej.

Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format e standardet që përdor INSTAT në metodat dhe përkufizimet e aplikuarat si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore.

### Dokumentimi i proceseve statistikore

INSTAT, për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara për tu kryer gjatë vitit 2017, zbatoi modelin e përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore, të implementuar në shumë shtete të Evropës dhe më tej. Ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur në prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarte dhe terminologji të harmonizuar. Në vitin 2017 INSTAT hartoi një kalendar pune mbi aktivitetet statistikore të cilat do të ishin pjesë e këtij modeli, si dhe ndërtoi një aplikacion mbështetës për ndjekjen dhe raportimin e tyre.

Në vitin 2018, do të fillojë procesi i dokumentimit të produkteve statistikore sipas fazave dhe nën fazave të modelit sipas një kalendari të caktuar për plotësim, ndjekje dhe monitorim. Deri në fund të vitit 2018 të gjitha aktivitetet statistikore do të jenë të dokumentuara sipas standarteve të përcaktuara në model.

### Auditi Statistikor

Auditimi statistikor është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. INSTAT gjatë vitit 2018 do të nisë punën për kryerjen e auditit të proceseve statistikore. Hapat që do të ndiqen lidhen me hartimin e pyetorisit i cili do të jetë për auditim me intervistim dhe vetvlerësim, hartimin e udhëzuesit të cilësisë dhe manualit të plotësimit. Në vazhdim do të kryhen testime mbi komponentë të veçantë të proceseve statistikore dhe procese pilot.

## Integrimi Evropian

---

INSTAT është përgjegjës për kapitullin 18 “Statistikat. Ky kapitull paraqet Acquis të BE-së në fushën e statistikave që do të zbatohen nga çdo aktor i përfshirë në Sistemin Kombëtar të Statistikave në Shqipëri me qëllim përmirësimin e infrastrukturës statistikore të bazuar në parime si paanshmëria, besueshmëria, transparencë, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.

Në kuadër të çeljes së negociatave, INSTAT ka filluar të kontribuojë me ekspertizën e tij në punën “Për hartimin e raportit statistikor për 5 prioritetet”, material i cili pritet të bëhet pjesë e dosjes së fushatës për mbështjen e hapjes së negociatave. Në bazë të 5 prioritetëve, INSTAT do të jetë pjesë e grupit kryesor dhe të 6 nën-grupeve të punës. Grupi kryesor i punës përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka për detyrë Koordinimin e procesit të punës. Ndërsa 6 nën-grupet e punës do të kenë nga dy përfaqësues të INSTAT.

Nëngrupet e punës janë të përcaktuara si në vijim:

- i. Nën-grupi i punës për të dhënat mbi reformën në administratën publike
- ii. Nën-grupi i punës për të dhënat e reformës në drejtësi si dhe për të dhënat për bashkëpunimin në fushën civile dhe penale:
- iii. Nën-grupi i punës për të dhënat statistikore për migracionin ligjor dhe të parregullt si dhe për azilin:
- iv. Nën-grupi i punës për të dhënat statistikore për luftën kundër krimit të organizuar
- v. Nën-grupi i punës për mbledhjen e të dhënave statistikore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut:
- vi. Nën-grupi i punës për mbledhjen e të dhënave statistikore për luftën kundër korrupsionit

Gjithashtu INSTAT, kontribuon me të dhëna për kapitujt e tjerë të *Acquis*.

## Cens 2020

INSTAT ka planifikuar të kryejë regjistrimin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave në vitin 2020. Ky cens do të ndjekë metodën e numërimit tradicional bazuar në operacionet në terren me intervista nga anketuesit derë më derë, por duke përdorur teknika të reja në procesin e mbledhjes së të dhënave.

Për të siguruar një operacion të suksesshëm të Cens-it, INSTAT ka draftuar një projekt dokument strategji që përmban një përshkrim të qasjes së Cens-it 2020, një listë paraprake të aktiviteteve që do të ndërmerren, një plan pune të përkohshëm dhe një vlerësim paraprak të buxhetit.

Për të marrë një vendim përfundimtar mbi qasjen më të përshtatshme të Cens-it të popullsisë në Shqipëri në vitin 2020 dhe për të përcaktuar më tej planin e aktiviteteve për fazën e para-regjistrimit, numërimit dhe pas-numërimit, planit të punës dhe buxhetit, INSTAT ka kërkuar mbështetje teknike nga ekspertiza ndërkombëtare për finalizimin e Dokumentit të Strategjisë së Cens-it. Mirëplanifikimi i këtij aktiviteti është veçanërisht i rëndësishëm duke marrë parasysh se Cens 2020 duhet të dizajnet i tillë që të shërbejë gjithashtu si bazë për Cens-in e ardhshëm në Shqipëri, që do të bazohet në përdorin e të dhënave administrative dhe potencialisht krijimin e regjistrave statistikore të popullsisë.


Më konkretisht aktivitetet e planifikuara për vitin 2018 janë detajuar në tabelën e mëposhtme. Ndërkohë që është paraqitur dhe skema e të gjitha aktiviteteve kryesore që do të ndërmerren gjatë viteve 2018-2022 deri në publikimet e rezultateve të Cens 2020.

**Tabela 1. Kalendari i aktiviteteve, Cens 2020**

<b>Aktivitetet për Cens 2020</b>	<b>Viti 2018</b>
Sigurim mbështetje financiare	Janar-Maj
Vlerësimi i situatës së burimeve administrative dhe strategjia e implementimit të Regjistrimit Statistikor të Popullsisë	Janar-Maj
Finalizimi i Projekt-Dokumentit për Strategjinë	Janar-Mars
Finalizimi i Buxhetit dhe Planit të Veprimit	Janar-Mars

Diskutimi dhe përcaktimi i nevojave dhe aktiviteteteve që do të mbështeten nga IPA 2015	Janar
Rishikimi i Ligjit dhe bazës ligjore për Cens-in	Janar-Qershor
Shkëmbime eksperiencash për aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare	Shkurt-Shtator
Draftimi i pyetsorit të CENS 2020	Shkurt-Prill
Diskutimi i nevojave të përdorueseve dhe prioriteteve të qeverisë	Maj-Qershor
Dizenjimi dhe sigurimi i infrastrukturës teknologjike të nevojshme	Janar-Dhjetor
Përditësimi i ZC-ve dhe Banesave	Mars-Dhjetor

Figura 1. Plani i aktiviteteteve për Cens 2020



## Publikimi dhe Shpërndarja e Statistikave

Aktivitetet e Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit në vitin 2018 janë ndërtuar duke u mbështetur në objektivat e PSZ 2017-2021 dhe Strategjinë e Zhvillimit të INSTAT. Strategjia e Komunikimit është strukturuar sipas 6 shtyllave të komunikimit.

**Objektiv i INSTAT** : Forcimi i Imazhit të INSTAT; Rritja e përdorimit të statistikave; Përmirësimi i njohurisë mbi statistikën.

**Shtylla 1:** Publikimet, përfshijnë aktivitetet tradicionale dhe të vazhdueshme duke filluar me Kalendarin e Publikimeve vjetore, sipas të cilit vijohet me përgatitjen dhe shpërndarjen e çdo publikimi. Publikimet tradicionale grupohen në publikime mujore, 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore, elektronike dhe të printuara. Gjithashtu planifikohet një aktivitet i ri për vitin 2018, Revista Shkencore, e cila do të ketë një publikim 6-mujor dhe do të krijohet në bashkëpunim me përfaqësues shkencor.

**Shtylla 2:** Marrëdhënia me Median & Publiciteti, përfshin aktivitetet tradicionale dhe të reja, të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Për një realizim sa më efikas të objektivave, aktivitetet mediatike janë grupuar në Monitorimin ditor, Njoftime për Shtyp javore, Intervista & Artikuj mujor, Konferenca shtypi 3-mujore, dhe evente për Mediat. Në vitin 2018 është planifikuar një event i ri Mediatik, udhëtimi i disa gazetarëve të përzgjedhur në Eurostat, si edhe seminare & workshop-e të reja dedikuar gazetarëve.

**Shtylla 3:** Media Dixhitale, është një aktivitet që do të marrë gjithmonë e më shumë përparësi në epokën e sotme, ku kanalet e komunikimit janë tashmë plotësisht dixhitalizuar. Për këtë arsye aktivitetet nën këtë shtyllë kanë për fokus mirëmbajtjen e kanaleve ekzistuese si dhe lançimin e kanaleve të reja, shoqëruar me ndërtimin e përmbajtjes. Kanalet duhen 'branduar' sipas imazhit të INSTAT si dhe duhet strukturuar përmbajtja sipas karakteristikave të ndryshme të natyrës dhe sjelljes së audiencës. Për këtë duhet të ndërtohet infrastruktura për menaxhimin e Komunikimit Dixhital, Rrjeteve Sociale dhe kontraktimi i një agjencie profesionale Grafike-Kreative.

**Shtylla 4:** Angazhimi me aktorët (Stakeholders) paraqet një shtyllë të rëndësishme komunikimi në forcimin e marrëdhënieve me të gjithë aktorët, të cilët i ndajmë në 3 kategori kryesore nga ku segmentet e identifikuar bëjnë pjesë në kategori të ndryshme si Përdorues, Prodhues & aktorë të brendshëm. Aktivitetet nën këtë shtyllë përbëjnë organizim eventesh për t'u lidhur me të gjitha audiencat nëpërmjet Seminareve & Workshop-eve me prodhues, Tavolina Rrumbullake

me autoritete të larta, Forume njohurie me bizneset, shkollat, politikëbërës lokal & qendror, organizatat jo qeveritare, etj. Gjithashtu planifikohet pjesëmarrja në panairë të partnerëve si Panairi i Punës ku INSTAT merr pjesë çdo vit, si dhe propozohet pjesëmarrja në Panairin e Agrobiznesit si një fushë me mjaft interes në ekonominë shqiptare.

**Shtylla 5:** Komunikimi i Brendshëm, përfshin aktivitete tradicionale dhe ri-strukturimin e disa aktiviteteve të organizuara edhe më parë. Buletini i brendshëm nisur për herë të parë këtë vit, do të vijojë gjatë vitit 2018 me periodicitetin mujor, do të përmirësohet në përmbajtje dhe në formë nga ana vizuale. Për të rritur shpërndarjen e informacionit ndërmjet departamenteve të INSTAT, propozohet të organizohet një event 3-mujor i quajtur “Biseda të Hapura” (Open Talk Sessions), ku i gjithë stafi është i ftuar të marrë pjesë dhe në çdo seancë një ose dy departamente do të prezantojnë të rejtat më të fundit të tyre.

**Shtylla 6:** Platforma e Markës përbën gjithashtu një shtyllë tepër të rëndësishme në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, ku marka duhet fuqizuar fillimisht në prezantimin e saj vizual duke krijuar guidën e markës që përcakton rregullat e përdorimit dhe të pamjes e karakterit që duhet të ketë marka për t’u njohur kudo. Me krijimin e guidës propozohet të vijohet me unifikimin e markës duke aplikuar këtë guidë në të gjitha materialet që prodhon instat, grafikë apo fizik, si publikime, video, materiale promovionale, etj.

**Fushata:** Mbështetur në këto shtylla, është planifikuar organizimi i katër fushatave për katër produktet më me interes gjatë vitit 2018. Këto fushata do të krijojnë një jehonë, duke përdorur një strategji të fokusuar në një event lançimi rreth së cilës do të shfrytëzohen kanale të ndryshme përfshirë fushatë në rrjetet sociale, buletine “direct marketing”, pjesëmarrje në emisione, shkrime artikuj nëpër media të ndryshme, etj. Fushtatat planifikohen rreth produkteve si Turizmi në shifra, Anketa Edukimit të të Rriturve, Burra & Gra, Vjetari Statistikor dhe Dita Evropiane e Statistikave.


**Menaxhimi për suportin e përdoruesve (Customer Service):** Një aktivitet operacional tepër i rëndësishëm për publikimin dhe shpërndarjen e statistikave gjatë vitit 2018 do të jetë mirëmbajtja e kërkesave për informacion nëpërmjet kanaleve të komunikimit: Protokollin Fizik, Emaili dhe Facebook.

## Sistemi i menaxhimit, raportimi dhe kontrollit

### Sistemi i Menaxhimit, raportimit dhe kontrollit

Sistemi i menaxhimit të INSTAT mbështetet në planifikimin, ndjekjen dhe raportimin e planeve të punës. Progresi i planit do të monitorohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, ku si instrument monitorimi do të shërbejë matrica e planeve të aktiviteteve të detajuara sipas drejtorive, pjesë përbërese e të cilës janë dhe planet e veprimit për realizimin e objektivave strategjik dhe indikatorëve të vlerësimit të performancës së institucionit. Ecuria e planit do të dokumentohet në një formë raporti të shkruar, në periudha tremujore. Në skemat e mëposhtme janë paraqitur strukturat e funksionimit të planifikimit dhe monitorimit të menaxhimit strategjik.

Figura 2. Planifikimi dhe monitorimi





**Indikatorët e vlerësimit të performancës**


INSTAT për të matur performancën e punës së tij në drejtim të planifikimit të aktiviteteve statistikore, monitorimit dhe raportimin e eficiencës së tyre ka përcaktuar 8 tregues për vitin 2018. Në tabelën në vijim janë paraqitur indikatorët e vlerësimit të performancës, statusi aktual për vitin 2017 dhe pritshmëritë për vitin 2018.

**Tabela 2. Indikatorët e Performancës**

Nr	Indikatorët	Përshkrimi	Statusi 2017	Synimi 2018
1	<b>Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM</b>	Numri i aktiviteteve statistikore të dokumentuara sipas modelit të përgjithshëm të dokumentimit të proceseve statistikore	0	49
2	<b>Numri i publikimeve të reja</b>	Numri i publikimeve të reja të shtrira gjatë një viti kalendarik, sipas Kalendarit të Publikimeve	41	48 (ose rritje me 17%)
3	<b>Numri i publikimeve në kohë</b>	Numri i publikimeve jashtë kohës së parashikuar në Kalendarin e Publikimeve.	5	0
4	<b>Numri i aktiviteteve që kanë përmirësim afati</b>	Numri i aktiviteteve të kryera përpara afatit gjatë një viti kalendarik.	4	27
5	<b>Indikatorët në botimet e vogla Evropiane</b>	Numri i indikatorëve nga Shqipëria në botimin e Eurostat (indikatorët kryesorë në vendet në zhvillim)	77%	85%
6	<b>Produkte statistikore bazuar në burime administrative, plotësisht dhe pjesërisht</b>	Numri i produkteve statistikore të cilat bazohen plotësisht dhe pjesërisht mbi të dhënat administrative	24	28
7	<b>Numri i aktiviteteve statistikore që kryhen në përputhje me standartet e EU</b>	Vlerësimi i numrit të aktiviteteve statistikore që kryhen në përputhje me standartet ndërkombëtare.	I Ulët-13	I Ulët-31
			I Mesëm- 13	I Mesëm- 20
			I Lartë- 1	I Lartë- 3
			Jo të përputhshëm- 38	Jo të përputhshëm- 11
8	<b>Numri i vizitave në web site të INSTAT</b>	Vlerësimi i numrit të shikuesve të faqes së Web-INSTAT	1.300.061 <sup>1</sup>	Rritje me 20%

<sup>1</sup> Numri i vizitave 1.300.061 rezulton deri në 16 Dhjetor 2017

Figura 3. Kuadri i menaxhimit strategjik



## Struktura organizative

Struktura organizative e INSTAT propozohet nga Këshilli i Statistikave dhe miratohet me urdhër të veçantë nga Kryeministri. Organet Drejtuese të Institutit të Statistikave janë:

- Këshilli i Statistikave
- Drejtori i Përgjithshëm

Numri i përgjithshëm i punonjësve të INSTAT sipas strukturës së miratuar është 216, nga të cilët:

- 199, është numri i pozicioneve të shërbimit civil
- 17, është numri i pozicioneve jashtë shërbimit civil.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të INSTAT fakt është 185, nga të cilët:

- 169, numri i punonjësve fakt të shërbimit civil
- 31, numri i pozicioneve vakante të shërbimit civil

Tabelat e mëposhtme paraqesin situatën aktuale të burimeve njerëzore të INSTAT. Ndërkohë që në vitin 2018, INSTAT-it i janë miratuar edhe 10 punonjës të rinj shtesë.


**Tabela 3. Burimet njerëzore të INSTAT**

Drejtoritë	Pozicione gjithsej	Të plotësuara	Vakante
Drejtor i Përgjithshëm	1	1	0
Koordinatorë	2	2	0
Sekretare	1	1	0
Spektori i publikimeve dhe shpërndarjes së Informacionit	4	4	0
Llogaritë Kombëtare	18	18	0
Statistikat e Sektorit Real	10	8	2
Statistikat Ekonomike	20	17	3
Statistikat Sociale	22	22	0
Statistikat e Bujqësisë	10	10	0
Teknologji Informacioni	23	16	7
Integrimi dhe Koordinimi i Projekteve	10	9	1
Financa dhe Shërbimet Mbështetëse	13	11	2
Statistika Rajonale	14	12	2
Audit i brendshëm	3	1	2
Zyrat Rajonale	49	37	12
Punonjës administrativë me klasë page	16	16	0
<b>Gjithsej</b>	<b>216</b>	<b>185</b>	<b>31</b>

Tabela 4. Punonjësit me kontratë afatgjatë dhe afatshkurtër

Pozicioni	Numri
Kontrollor	166
Operator	109
Anketues Afatgjatë	636
Anketues Afatshkurtër	1015

Figura 4. Organigrama e INSTAT





**II. Të ardhurat e krijuara nga aktivitetet dytësore**

Prej më se 10 vjetësh, INSTAT kryen shërbimin e mbledhjes së informacionit statistikor për llogari të Bankës së Shqipërisë. Përdorimi i të ardhurave kryhet në përputhje me VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” si dhe Udhëzimit të përbashkët Nr.1, date 11.10.2006 të Ministrisë së Financave, nënshkruar nga Ministri i Financave me shkresën Nr.3423/1 Prot, datë 23.05.2007.

Për vitin 2018, të ardhurat e krijuara nga vërtetimet për BSh parashikohet të jenë si vijon.

**Tabela 6. Të ardhura dytësore**

në 000 lekë

Lloji i Të Ardhurave	Baza Ligjore, Ligj, VKM, Udhëzime, numër dhe data e miratimit	Parashikimi për vitin 2018	
		Nga të Cilat	
		I takojnë Institucionit	Derdhen në Buxhetin e Përgjithshëm
Të ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejtë	VKM 432 dt 28.06.06 U.M.Fin Nr 1 dt 23.05.07	32,250	3,574

Fondet që i takojnë institucionit janë të destinuara kryesisht për mbulimin e pagave, dietave dhe të tjera.

**III. Financimet e huaja****Tabela 7. Të ardhurat nga financimet e huaja**

Nr.	Projekti	Vlera e financimit të huaj	Kontributi i INSTAT si bashkë financues TVSH	Detyrime të pa likujduara
1	IPA 2013	1,500,000 Euro	269,364 Euro	120,000 Euro
2	Sida Projekt	2,253,605 Euro	N/A	N/A
3	Sida Projekt « Fonde Direkte për prokurim IT”	774,809 Euro	155,000 Euro	94,000 Euro

## Planet e punës

---

Gjatë vitit 2018 INSTAT është angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit Kombëtar Statistikor 2017-2021 dhe planet strategjike. Në vijim të këtij seksioni janë paraqitur shkurtimisht planet e punës së drejtorive, të cilët kanë në fokusin e tyre:

1. Përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjive për harmonizim me rregulloret dhe standartet ndërkombëtare
2. Shtimin e numrit të produkteve statistikore
3. Shtimin e treguesve statistikore
4. Rritje e burimeve të informacionit
5. Reduktimin e afateve kohore të publikimeve
6. Përmirësimin e publikimeve në formë dhe në përmbatje
7. Përmirësimin e infrastrukturës teknologjike
8. Modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave
9. Përmirësim të cilësisë

Për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin vjetor 2018, INSTAT do të mbështetet me asistencë teknike dhe financiare nga projektet e IPA shumë-përfituese (Multi-Beneficiary, MB) 2015, IPA 2013, IPA II SMEI<sup>2</sup>, Fondi Monetar Ndërkombëtar, SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Kombet e Bashkuara (UN), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO), si dhe Banka Botërore (BB).

---

<sup>2</sup> SMEI-Rritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare të Inovacionit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

## Drejtoria e Llogarive Kombëtare

Misioni kryesor i Drejtorisë është prodhimi dhe publikimi i treguesve kryesorë të Llogarive Kombëtare, me frekuencë vjetore, të miratuara në programin e Statistikave Zyrtare.

Drejtoria është e përbërë nga 4 sektorë dhe një staf prej 18 punonjësish.

Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Llogarive Kombëtare do të mbështetet nga projektet IPA shumë-përfituese 2015, nga projekti i FMN i financuar nga SECO dhe Programi i asistencës teknike të FMN. IPA shumë-përfitues 2015 ka filluar në vitin 2017 dhe janë tetë projekte pilote në fushën e Llogarive Kombëtare, zhvillimet më të rëndësishme të të cilave shprehen si më poshtë:

- *IPA 2015 MB PP1.1 Statistikat Financiare të Qeverisë* – Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i cilësisë së treguesve të statistikave financiare të qeverisë si dhe integrimi i këtyre treguesve me raportimet e tjera të INSTAT për treguesit të qeverisë.
- *IPA 2015 MB PP1.3 Metodologjia e Llogarive Kombëtare* – Qëllimi kryesor është përmirësimi i vlerësimeve më çmimet e vitit të mëparshëm, shërbimet e banesave, stokut të kapitalit, konsumit të familjeve, vlerësimet mbi zyra e këmbimit valutor dhe sistemit të armatimeve.
- *IPA 2015 MB PP1.4 Programi i Transmetimit ESA 2010 dhe Llogaritë Tremujore* – Pjesa ku Drejtoria e Llogarive Kombëtare është e lidhur me këtë projekt pilot është krijimi i një databaze për Llogaritë Kombëtare, e cila do të krijojë mundësinë e transmetimit të të dhënave në EUROSTAT nëpërmjet SDMX.
- *IPA 2015 MB PP1.5 Llogaritë Rajonale* – Qëllimi kryesor i këtij Projekt piloti është përmirësimi i vlerësimit të llogarive rajonale dhe rritja e mbulimit të të dhënave sipas programit të transmetimit të të dhënave ESA 2010
- *IPA 2015 MB PP1.6 Sektorët Institucional* – Synon vlerësimin në formë eksperimentale të setit të plotë të llogarive sipas sektorëve institucional, për vitet 2013, 2014.
- *IPA 2015 MB PP1.7 Tabelat Burim-Përdorime* – Deri në fund të projektit synohet ndërtimi i moduleve të reja dhe zhvillimi i sistemit “NA\_Builder” për përpilimin e tabelave të burim, përdorimeve (TBP) dhe input-output (TIO), zhvillimi i mëtejshëm i metodologjisë së përpilimit dhe të dhënave të përdorura, ndërtimi i një plani pune afatmesëm për integrimin e TBP-ve në vlerësimin e llogarive vjetore.



- *IPA 2015 MB PP1.8 Ekonomia e Pavrojtuar* –Fokusi kryesor i këtij projekt piloti do të jetë përmirësimi i vlerësimeve aktuale të ekonomisë së pavrojtuar duke shtuar edhe elementë të rinj sic është ekonomia ilegale.
- *IPA 2015 MB PP7.1 Treguesit e Procedurës së Disbalancës Makroekonomike* – Procedura e Disbalancës Makroekonomike (Macroeconomic Imbalance Procedure - MIP) është një sistem për monitorimin e politikave ekonomike dhe zbulimin në kohë të rreziqeve të mundshme në funksionimin normal të ekonomisë së Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian në tërësi. Projekti i ri ka për qëllim mbulimin e treguesve kryesor të MIP të pa mbuluar në projektin e IPA 2014 shumë-përfitues dhe gjithashtu plotësimi me të dhëna dhe dokumentacionin e duhur të treguesve ndihmës të MIP.

Projekti SECO ka si objektiv kryesor koordinimin e punës ndërmjet INSTAT, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, për ndërtimin e një sistemi shkëmbimi dhe vlerësimi të informacioneve mbi statistikën financiare të Qeverisë (GFS), finalizimin e raportimit të EDP dhe materialin e inventarit metodologjik të EDP. Meqë fokusi është në statistikën e qeverisë për BE, INSTAT do të ketë rolin e koordinatorit të këtij projekti.

Drejtoria do të asistohet gjithashtu edhe nga programi i Asistencës teknike të FMN, i cili në Janar 2018 do të zhvillojë misionin e radhës për përcaktimin e objektivave kryesorë ku do të fokusohet kjo asistencë për vitet në vazhdim.

Gjatë vitit 2018, Drejtoria do të vijojë punën për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare, me fokus kryesor në përmirësimin e metodologjisë së treguesve të Llogarive Kombëtare Vjetore, reduktimin e afateve kohore dhe zbatimin e programit të transmetimit ESA 2010. Prioritet i punës së Drejtorisë do të jetë reduktimi i afateve kohore për publikimet më të rëndësishme, si më poshtë:

- Publikimin e treguesit të Produktit të Brendshëm Bruto (finale 2015 dhe gjysmë finale 2016), në dt.02 Prill 2018, duke reduktuar afatin e publikimit me 52 ditë kalendarike.
- Publikimi i Llogarive Rajonale 2016, në dt. 11 Qershor 2018, duke reduktuar afatin e publikimit me 50 ditë kalendarike.
- Vendosja në aktivitetin rutinë të Drejtorisë të publikimit të dy Llogarive të para sipas sektorëve institucional, në dt. 30 Maj 2018

## Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real

Misioni kryesor i Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real (DSSR) është prodhimi dhe publikimi i treguesve kryesorë të Llogarive Kombëtare Tremujore, Indekseve të Çmimeve të Konsumit, Paritetit të Fuqisë Blerëse, etj, të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe në planin vjetor të punës të Institutit të Statistikave. Gjithashtu, pjesë e misionit të DSSR është dhe integrimi i të dhënave ekonomike mujore e tremujore, të nevojshme për analiza dhe ndërtimin e modeleve statistikore, të cilat do të sigurojnë bazat për zhvillimin e mëtejshëm të statistikave mikro e makroekonomike si dhe vlerësimin e ecurisë së ekonomisë në periudhat më të afërta.

Aktualisht drejtoria përbëhet nga 3 sektorë dhe 10 persona, të cilët do të punojnë për përmbushjen e objektivave në kuadër të PSZ dhe të projekteve të ndryshme të programeve shumë-përfituese të bashkëpunimit statistikor dhe asistencave teknike.

Në fokus të veprimtarisë të Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real, gjatë vitit 2018 do të jetë përmirësimi i metodologjive dhe cilësisë së treguesve mujor e tremujor në përputhje rregulloret e BE-së, reduktimi i afateve kohore, shtimi i treguesve të rinj si dhe publikimi e shpërndarja e të dhënave sipas kalendarit të Publikimit dhe programeve të transmetimit në Eurostat e FMN.

Aktivitetet kryesore që janë planifikuar të ndërmerren nga Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real gjatë kësaj periudhe do të mbështeten nga projektet si më poshtë:

- *IPA 2015 MB PP1.4 Programi i Transmetimit ESA 2010 dhe Llogaritë Tremujore* – Objektivat e projektit janë: Përmirësimi metodologjik i vlerësimeve të PBB-së tremujore me metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve; Implementimi i metodologjisë ESA 2010 dhe klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NVE Rev.2 në PBB tremujore për periudhën T1/2003-T4/2007, duke siguruar një seri të gjatë kohore për krijimin e modeleve dhe parashikimeve të ekonomisë; si dhe Ndërtimi i një sistemi (programi informatik) për përmirësimin e proceseve të punës nga marrja e të dhënave deri në llogaritjen dhe shpërndarjen e treguesit të PBB-së tremujore
- *IPA 2015 MB PP 2.1 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit*- Objektivat kryesore janë: Përcaktimi i produkteve, çmimet e të cilave janë plotësisht ose pjesërisht të administruara nga institucionet e Qeverisë apo Ente të ndryshme rregullatore si dhe dërgimi i kësaj liste në Eurostat; Përmirësimet metodologjike të llogaritjes së çmimeve IHÇK

- për hotelet, paketat turistike, makinat e reja dhe të përdorura; Analiza e burimeve të të dhënave potenciale dhe përdorimi i tyre për llogaritjen e indeksit të çmimeve të banesave.
- *IPA 2015 MB PP 2.2 Matja e Paritetit të fuqisë blerëse* – Fokusi kryesor i këtij projekti do të jetë kryerja e anketave specifike që kërkohen nga Eurostat, si dhe sigurimi i të dhënave shtesë për vlerësimin e paritetit të fuqisë blerëse.
  - *Programi i Asistencës teknike të FMN*, i cili në Janar 2018 do të zhvillojë misionin e radhës për përcaktimin e objektivave kryesorë ku do të fokusohet kjo asistencë për vitet në vazhdim.
  - *Asistencë teknike nga projekti suedez SIDA* lidhur me të dhënat administrative, outputet e të cilës do të jenë: Rritje e përdorimit të burimeve administrative të Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSH dhe Listëpages; Përpunimi, editimi dhe analiza e të dhënave administrative për krijimin e një baze të dhënash me cilësi të lartë në funksion të zëvendësimit, plotësimit, mbështetjes së të dhënave të mbledhura nga anketat si dhe prodhimit prej tyre të produkteve të reja statistikore dhe analitike.

Disa nga risitë që priten të realizohen nga Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real në vitin 2018, janë:

1. Llogaritja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit-Taksa Konstante
2. Vlerësim eksperimental i Indeksit të Çmimeve të Banesave
3. Prodhimi i treguesit të Shitjeve nga burime administrative

## **Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit**

Misioni kryesor i Drejtorisë është prodhimi dhe publikimi i treguesve kryesorë të Bujqësisë, Blegtorisë, Pyjeve dhe Biodiversitetit, Mjedisit si dhe Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis, me frekuencë dyvjeçare, vjetore, tremujore dhe mujore, të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe në planet vjetore të punës.

Drejtoria është e përbërë nga 3 sektorë dhe një staf prej 10 punonjësish. Baza metodike e produkteve të prodhuara, synohet të jetë e harmonizuar rregulloret më të fundit të Bashkimit Evropian, Rregullore Nr. 1166 mbi, “Strukturën e fermave bujqësore”, Rregullore Nr. 543/2009 mbi “Statistikat vjetore të prodhimit bimor”, Rregullore Nr. 1337/2011 mbi “Statistikat e drufrutorëve, në linjë me Kodin e Praktikave Evropiane.

Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit do të mbështetet nga projektet IPA shumë-përfituese 2015 dhe SIDA kombëtar si më poshtë:

- *IPA 2015 MB PP5.1 Statistikat Vjetore të Prodhimit Bimor* - Qëllimi kryesor është përmirësimi i treguesve të prodhimit bimor, realizimi i një ankete të re, transmetimit të të dhënave në EUROSTAT dhe llogaritja e serisë kohore 2012-2016.
- *IPA 2015 MB PP5.4 Tipologjia dhe Struktura e Fermave Bujqësore* – Qëllimi kryesor është përgatitja dhe dërgimi i të dhënave të Cens-it të Bujqësisë 2012 në databazën e Eurofarm, llogaritja e koeficientëve të Standart Output (SO) 2010 në data bazën e Eurofarm dhe përgatitjen e Raportit metodologjik kombëtar mbi Cens-in e Bujqësisë 2012.
- *IPA 2015 MB PP.5.2 Statistikat e Prodhimit Blegtoral*: Qëllimi kryesor është rritja e cilësisë së indikatorëve të statistikave të blegtorisë dhe prodhimit blegtoral si dhe plotësimi i serisë kohore për vitet 2012, 2013 dhe 2016, duke u bazuar në të dhënat e cens-it, vrojtimit vjetor 2013 dhe rezultatet e vrojtimit vjetor 2016. Ndarja e vrojtimit vjetor të blegtorisë nga vrojtimi vjetor i prodhimit bimor si kusht për rritjen e cilësisë së treguesve. Gjithashtu do të ndërtohet seria kohore e therjeve jashtë thertoreve duke u bazuar në të dhënat e vrojtimit vjetor 2013 dhe 2016.
- *IPA 2015 MB PP5.3. Statistikat Agro-Monetare*. Dy fushat kryesore ku bazohet ky projekt, janë:
  - Llogaritë ekonomike në Bujqësi dhe Inputet e Punës në Bujqësi

- Llogaritja dhe trasmetimi i çmimeve absolute bujqësore të prodhimit, të inputeve si dhe indekset e tyre.

Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit do të asistohet gjithashtu edhe nga programi i SIDA për:

- 1- Statistikat e pyjeve në lidhje me përmirësimin e cilësisë; shtimin e numrit të indikatorëve apo publikimeve si dhe të raportimeve në EUROSTAT;
- 2- Statistikat e llogarive rrjedhëse fizike të energjisë

Gjatë vitit 2018, Drejtoria do të vijojë punën për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare, me fokus kryesor në përmirësimin e metodologjisë, shtim të treguesve të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, reduktimin e afateve kohore dhe zbatimin e programit të trasmetimit të të dhënave në EUROSTAT.

Publikime të reja të planifikuara nga Drejtoria në 2018 do të jenë:

- Indeksi i çmimeve në bujqësi
- Treguesit e mbetjeve industriale
- Treguesit mbi përdorimin e ujit në industri
- Llogaritë fizike të mjedisit

## Drejtoria e Statistikave Ekonomike

Drejtoria e Statistikave Ekonomike (DSE) përcakton, harton, përpunon dhe publikon të gjithë treguesit ekonomikë statistikorë të ndërmarrjeve, shkëmbimit të mallrave dhe çmimeve të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe në planin vjetor të punës të Institutit të Statistikave, me frekuenca mujore, tremujore dhe vjetore.

Drejtoria është e përbërë nga 4 sektorë dhe ka 20 poste pune me një staf prej 17 persona të punësuar. Për zhvillimin e mëtejshëm të treguesve ekonomikë, në kohë dhe cilësi, për rritjen e përputhshmërisë me standardet evropiane, drejtoria ka kryer aktivitetet statistikore me mbështetje nga buxheti i shtetit dhe asistenca teknike nëpërmjet projekteve për partneritet dhe paraadherim në BE.

Asistenca e planifikuar gjatë vitit 2018 do të synojë në përmirësimin e komponentëve statistikorë si më poshtë:

- *IPA MB 2014 – PP 15 – Statistikat e Turizmit* – ky projekt vazhdon nga viti 2017, gjatë të cilit u zhvillua piloti i Anketës së Strukturave Akomoduese, Prill 2017 dhe terreni i Anketës për periudhën Qershor-Nëntor 2017 (çdo muaj). Në 2018 do të hidhet në terren kjo anketë mujore për periudhën Dhjetor 2017 – Qershor 2018. Ndërkohë që do të dërgohen në Eurostat të dhënat paraprake vjetore (7 muajt e parë) në Qershor 2018, të dhënat vjetore (12 muajt) dhe raporti final në Shtator 2018, kurse progres raporti në Tetor 2018.
- *IPA MB 2015* - Ky projekt ka filluar në Korrik 2017 dhe mbaron në Korrik 2019 dhe mbështet DSE me 4 projekte pilot:
  1. *IPA MB 2015 PP3.1 – Përmirësimi i regjistrit statistikor kombëtar të ndërmarrjeve*— qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve duke përmirësuar fushën e mbulimit të njësive statistikore; shfrytëzimin më të mirë të burimeve të të dhënave administrative të përdorura; përmirësimin të proceseve të mirëmbajtjes, përdorimit dhe aksesit të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve;
  2. *IPA MB 2015 PP3.2 – Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve*— Puna do të ndahet në dy faza:
    - a. Vlerësimi i situatës aktuale për gjithë procesin e llogaritjes së treguesve të Anketës Tremujore të Ndërmarrjeve (raportimi i ndërmjetëm Janar 2018),

prezantim në workshopin që do të organizohet me gjetjet kryesore të këtij raporti (Shkurt 2018) dhe Raportimi final (Maj 2018);

- b. Deri në fund të projektit IPA 2015, përmirësime të qëndrueshme duhet të arrihen në zbatimin e udhëzimeve për rregullimin kalendarik dhe sezonal, përmirësimin e procesit të validimit të të dhënave, cilësi më të mirë dhe përmirësim i afateve kohore të publikimit të treguesve dhe transmetimit të tyre në Eurostat.
3. *IPA MB 2015 PP3.3 – Statistikat e Transportit të Pasagjerëve dhe Mallrave* - Aktivitetet që priten të zhvillohen janë dizenjimi i pyetësorit të anketës të transportit rrugor të mallrave në 30 Prill 2018, kryerja e pilotit të anketës të transportit rrugor të mallrave në Tetor 2018, dërgimi i të dhënave mikro nga anketa e transportit rrugor të mallrave, të metadatës në Eurostat në 31 Dhjetor 2018 dhe në 30 Prill 2019 përshkrimi i cilësisë të pilotit të anketës (gabimet, mos-përgjigjet, etj.)
4. *IPA MB 2015 PP3.6 – Statistikat e Energjisë* – projekti ka si objektiv krijimin një harte (road –map) për statistikave të energjisë dhe të Raportit të Cilësisë. Aktualisht është zhvilluar një mision nga asistenca teknike afatshkurtër në datat 4-5 Dhjetor 2017, ku u bë një vlerësim i situatës ekzistuese për të dhënat e Energjisë në INSTAT dhe institucionet e tjera.

Komponentë të tjerë të IPA 2015 MB ku drejtoria është e angazhuar por jo drejtuese janë projekt pilotet PP3.5 – Statistikave të shoqërisë informacionit (ISS) dhe PP7.3 – Indikatorët e Evropës Jug-lindore 2020 (SEE2020).

Gjatë vitit 2018 puna e drejtorisë do të përqëndrohet në përmirësimin e cilësisë (15 aktivitete), shtimin e treguesve në aktivitetet historike dhe aktivitete të reja (13 aktivitete), mbulim më të mirë (1 aktivitet) dhe përmirësimin e afateve kohore (4 aktivitete). DSE ka planifikuar të publikojë produkte të reja gjatë vitit 2018 si më poshtë:

1. Energjia Elektrike Tremujore;
2. Turizmi në Shifra, vjetore;
3. Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, Rajonale

## Drejtoria e Statistikave Sociale

---

Misioni kryesor i Drejtorisë është prodhimi dhe publikimi i treguesve statistikorë socialë, të miratuar në Programin e Statistikave Zyrtare dhe në planin vjetor të punës. Treguesit socialë japin një informacion të rëndësishëm mbi karakteristikat demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë siç janë punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, niveli i jetesës, barazia gjinore, shëndeti, arsimi, kultura dhe siguria.

Drejtoria është e përbërë nga 5 sektorë dhe ka një staf prej 22 punonjësish.

Treguesit socialë janë të shumtë dhe përdorimi i tyre mjaft i gjerë. Prodhimi i tyre mbështetet në bashkëpunimin e frytshëm edhe me partnerë ndërkombëtarë si, projektet e IPAs dhe Eurostat, SIDA në bashkëpunim me Statistikat e Suedisë por dhe organizata të ndryshme që mbështesin zhvillimin e vendit: Banka Botërore, Kombet e Bashkuara dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës.

Gjatë vitit 2018, aktivitetet e DSS do vijojnë të mbështeten nga projektet IPA multi-përfutuese 2015. Këto projekte do të aktivizojnë lidhur me treguesit socialë, për dy vitet në vazhdim 4 projekte pilot:

- *IPA MB PP 3.5 - Anketa mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në familje:* në vitin 2018 do të kryhet anketa në shkallë të gjerë për të studiuar përdorimin e TIK dhe faktorët që e ndikojnë atë në familje dhe individë.
- *IPA MB PP 4.1 – Anketa e Forcave të Punës:* qëllimi kryesor i këtij projekti pilot është përdorimi i programeve të validimit të të dhënave të Anketës së Forcave të Punës, duke përfshirë shtim dhe përditësim të vazhdueshëm të treguesve të anketës.
- *IPA MB PP 4.2 - Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës:* në vitin 2018 synohet të ngrihet struktura e pastrimit të të dhënave cross-sectional dhe longitudinal. Ekspertizë do të merret edhe për kontrollin dhe gjenerimin e programeve të Eurostat.
- *IPA MB PP 4.4 – Statistikat e Krimeve:* do të vazhdojnë aktivitetet e projektit pilot duke mbështetur zhvillimet në këtë fushë përsa i përket rritjes së cilësisë së të dhënave të krimeve dhe drejtësisë penale, efijencës së lidhjeve midis INSTAT dhe autoriteteve kombëtare furnizuese me të dhëna dhe do të finalizohet harta e përputhjes së kodifikimit kombëtar të krimeve sipas kodit penal me klasifikimin ndërkombëtar për qëllime statistikore.



Drejtoria do të vazhdojë të mbështetet nga Projekti SIDA për të përfunduar proceset e dy aktiviteteve statistikore:

- Anketa e Buxhetit të Familjeve – me fokus rishikimin e pyetësorit për të rritur përputhjen me Eurostat dhe ndryshimin e metodologjisë në mbledhjen e të dhënave për të ulur ngarkesën e intervistimit të familjeve, koston përsa i përket burimeve njerëzore dhe financiare dhe rritjes së cilësisë të informacionit të mbledhur.
- Publikimin e një raporti analitik mbi statistikatat juridike ku do të përfshihen të dhëna nga të gjitha burimet furnizuese dhe me një qasje të strukturuar analitike për t'i dhënë përdoruesit një panoramë të këtij fenomeni nga këndvështrimi i statistikave juridike.

Gjatë vitit 2018, Drejtoria do të vijojë punën me përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare me fokus kryesor në përmirësimin e metodologjisë së treguesve socialë, shtimin e treguesve dhe publikimeve me fokus përshkrimin analitik të fenomeneve të përshkuara, përmirësimin e publikimeve egzistuese për të rritur përdorimin dhe vlefshmërinë e tyre tek përdoruesit, rritjen e përputhshmërisë me standartet e Eurostat dhe transmetimin e të dhënave.

Zhvillimet e reja të Drejtorisë në këtë vit do të fokusohen në aktivitetet e mëposhtme:

- Përmirësimi i treguesve të migracionit, vlerësimit të popullsisë me vendbanim të zakonshëm dhe përditësimi i projeksioneve;
- Analiza e rezultateve të vrojtimit të reja të ndërmarra në vitin 2017: Anketa e Arsimit të Rriturve dhe Anketa e Turizmit në Familje;
- Analiza e Rezultateve të Studimit të Demografisë dhe Shëndetit realizuar në vitin 2017;
- Analiza e efektit të standarteve të reja ndërkombëtare të statistikave të tregut të punës mbi treguesit kryesorë të tregut të punës, bazuar në Anketën Pilot të Standardeve të Reja të Punësimit;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Kostos së Punës dhe një publikim specifik për pagat në Shqipëri.
- Publikimi i Raportit Analitik mbi Statistikatat Juridike dhe publikime të veçanta në fushën e arsimit dhe shëndetit.
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për implementimin e klasifikimeve ndërkombëtare ICD-10 dhe ISCED 2011.

## Drejtoria e Statistikave Rajonale

Drejtoria e Statistikave Rajonale (DSR) ka mision mbështetjen e gjithë procesit të prodhimit të statistikave zyrtare nëpërmjet menaxhimit të procesit të mbledhjes së të dhënave për qëllime statistikore, monitorimit të vrojtimeve në terren për të siguruar plotshmërinë e informacionit, përfundimin në kohë dhe me efikasitet të vrojtimeve statistikore, si dhe kontrollin e informacionit të mbledhur.

Drejtoria e Statistikave Rajonale ka në strukturën e saj 3 sektorët e mëposhtëm:

1. Sektori i Koordinimit të Mbledhjes së të Dhënave
2. Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Mbledhjes së të Dhënave
3. Sektori i Hartografisë dhe GIS
4. 12 Zyra rajonale statistikore

Aktivitetet kryesore të Drejtorisë lidhen me:

- Krijimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin informacionin gjeohapësinor për qëllime statistikore, duke mbështetur zhvillimin dhe prodhimin e statistikave me mjetet që ka në dispozicion për planifikimin, mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të gjeoreferuara sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë dhe standarteve/rekomandimeve evropiane në funksion të prodhimit të statistikave asnjëherë transparente dhe të përditësuar.
- Përditësimin e bazës së të dhënave të njësive gjeografike statistikore në përputhje me standardet e EUROSTAT dhe rekomandimet ndërkombëtare (UNECE, UNSD).
- Mbështetjen e aktiviteteve statistikore (anketa) në planifikim dhe monitorim të procesit.
- Përdorimin e analizave hapësinore për krijimin e hartave tematike dhe analizave territoriale.
- Mirëmbajtjen dhe përditësimin e gjeoportalit [www.instatgis.gov.al](http://www.instatgis.gov.al) "Atlasi Statistikor i Shqipërisë" me të dhëna statistikore të referuara gjeografikisht në nivel rajonesh, njësisish lokale dhe rrjeti qelizash grid.

Për vitin 2018 fokusi i drejtorisë do të jetë drejtim të:

1. Përmirësimit të metodave të mbledhjes së të dhënave, mbështetur në propozimet e drejtorive prodhuese të statistikave zyrtare.
2. Koordinimin e shpërndarjes efikente të ngarkesës së punës (kampion-anketues),

3. Mbledhjen dhe kontrollin në kohë të informacionit.
4. Përgatitjen e botimit të treguesve statistikorë rajonale për publikim.
5. Përmirësimin e punës së zyrave rajonale në drejtim të ngritjes së kapaciteve të burimeve njerëzore, përgjegjësive që ato kanë dhe raporimit.

Aktivitet tjetër i Drejtorisë është angazhimi në projektin *“Forcimi i statistikave lokale shqiptare (Strong Albanian Local Statistics-SALSTAT)”*.

Mbështetja Zvicerane në Shqipëri për statistika të forta në nivel lokal është pjesë e programit "Bashki të Forta", i financuar nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC) për periudhën Qershor 2017 - Maj 2024. SALSTAT menaxhohet dhe mbështetet nga Zyra Federale e Statistikave Zvicerane (FSO) dhe implementuar nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë në koordinim me SDC dhe Ambasadën e Zvicrës në Tiranë.

Synimi i përgjithshëm i SALSTAT është krijimi i një sistemi treguesish statistikor lokalë dhe rajonalë, duke u bazuar sa më shumë që të jetë e mundur në të dhënat administrative dhe regjistrat në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar dhe të koordinuar nga INSTAT. Kjo do të përfshijë mbështetjen për zhvillimin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2020 dhe krijimin e kushteve për Cens të bazuar në regjistra në afat të gjatë.

Projekti përfshin një fazë fillestare nga qershori 2017 deri në fund të majit 2018. Gjatë fazës së fillimit do të analizohet mundësia e ndërhyrjeve programore, identifikimi i partnerëve kryesorë dhe zhvillimi i dokumentit të projektit (përfshirë buxhetin) të fazës së zbatimit nga qershori 2018 deri në maj 2022. Një fazë e dytë zbatimi do të pasojë nga qershori 2022 deri në maj 2024.

## Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit

Misioni i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit është të krijojë një mjedis teknologjik të përshtatshëm për nxjerrjen e statistikave zyrtare, në mbështetje të kryerjes së aktiviteteve statistikore.

Puna e drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit mbështetet në 6 sektorë. Drejtoria përbehet nga një staf prej 25 punonjës, aktualisht ka 18 punonjës.

Në mbështetje të PSZ, për vitin 2018 puna e drejtorisë do të përqëndrohet në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, përmirësimin e cilësisë dhe metodologjisë së vrojtimeve. Do të hartohen udhërrëfytes (guidelines) për sigurimin e konfidencialitetit statistikor si për të dhënat mikro edhe për ato tabulare, si dhe do të kryhet vlerësimi i situatës mbi zgjidhjen e mundshme teknike për aksesimin e sigurtë nga ana e përdoruesve të jashtëm të të dhënave statistikore. Publikimi në faqen zyrtare të INSTAT i informacionit të nevojshëm lidhur me Metadatave strukturore/ klasifikimet, do të realizohet në fillim të vitit 2018. Në mbështetje të standardizimit të metadatave referenciale, mbledhja, menaxhimi, dërgimi në Eurostat i tyre do të realizohet nëpërmjet sistemit IT të implementuar. Në kuadër të datawarehouse statistikor, gjatë 2018 do të implementohet sistemi i integruar(SITI) për mbledhjen e të dhënave (IPA 2013) si edhe do të hartohet plani për popullimin e SITI për produktet statistikore dhe ndiqet në vazhdimësi. Në kuadër të projektit Sida do të punohet për hartimin e një strategjie për Disaster Recovery.

Gjatë vitit 2018 puna e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit do të mbështetet nga IPA 2013 Kombëtare, IPA shumë-përfituese 2015, Partneriteti për statistikat në Shqipëri, faza 5 (Sida) si edhe Sida Financim Direkt për Prokurim të pajisjeve të IT dhe krijimin e qendrës së trajnimeve.

- *IPA 2013 Kombëtare*: ofron asistencë teknike në fushën e Teknologjisë së Informacionit bazuar në konceptin e një data warehouse statistikor, për të lehtësuar procesimin dhe shpërndarjen e statistikave cilësore.
- *IPA shumë-përfituese 2015 PP6.1 për Menaxhimin e Cilësisë*: ofron asistencë teknike për përmirësimin e menaxhimit të cilësisë statistikore, mbështetur në praktikat më të mira evropiane si edhe rishikimin e cilësisë së produkteve statistikore.
- *IPA shumë-përfituese 2015 PP6.2 për Implementimin e Standardeve për Shkëmbimin e të Dhënave dhe Metadatave*: ofron asistencë teknike për përmirësimin e sistemeve të

metadatave bazuar në rekomandimet e sistemit statistikor evropian, implementimin e standardeve teknike dhe statistikore si edhe infrastrukturën e nevojshme për SDMX.

- *Partneriteti për statistikat në Shqipëri, faza 5 (Sida)* – ofron asistencë teknike për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve eficiente, transparent dhe lehtësisht të menaxhueshme të Teknologjisë së Informacionit.
- *Sida Financim Direkt për Prokurim të pajisjeve të TI dhe krijimin e qendrës së trajnimeve:* Qëllimi i projektit është blerja e pajisjeve të TIK për përmirësimin e proceseve të prodhimit dhe shpërndarjes së të dhënave statistikore; për të pajisur stafin e institucionit me PC të reja, për të ndërtuar një qendër trajnimi dhe rinovuar gjithë pjesën kryesore të pajisjeve të infrastrukturës TI të INSTAT.

## **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është të sigurojë mbështetje në kohë me personel dhe bazë materiale drejtoritë e institucionit, të hartojë politika për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, të interpretojë probleme juridike brenda institucionit dhe në marrëdhënie me të tretët. Gjithashtu, drejtoria kujdeset për proceset e mirëmbajtjes së godinës dhe aseteve të saj, kryen likuiditetet sipas praktikave dhe procedurave përkatëse, etj.

Drejtoria është e përbërë nga tre sektorë dhe ka një staf prej 24 punonjësish. Drejtoria është e natyrës mbështetëse dhe është pjesë përfituese e projektit Sida mbi përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore duke përdorur instrumente të rinj për matjen e performancës së stafit, kohën e punës, menaxhimin e trajnimeve, mbajtjen e rekordeve dokumentare të specialistëve, etj.

Në vitin 2018, drejtoria do të fokusohet në këto aktivitete të reja:

1. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve. Me mbështetjen e projektit Sida, pranë INSTAT është ngritur qendra e trajnimit, infrastrukturë e domosdoshme për zhvillimin profesional të stafit të SKS, përdoruesve, medias dhe botës akademike.
2. Blerja e një Software për menaxhimin e informacionit për Burimet Njerëzore (me mbështetjen e projektit Sida), sistem i cili do të mundësojë jo vetëm mbajtjen e rekordeve për secilin punonjës, por edhe pasqyrimin e indikatorëve të performancës dhe eficiencës në kryerjen e detyrave e përgjegjësive.
3. Krijimi i një ambienti pune motivues.
4. Përditësimin dhe përmirësimin e urdhrave dhe/ose akteve të tjera që rregullojnë proceset e punës në përmbushje të detyrimeve ligjore
5. Përditësimin dhe përmirësimin e urdhrave dhe/ose akteve të tjera që rregullojnë proceset e punës në përmbushje të detyrimeve ligjore
6. Ngritjen e sistemit planifikues dhe standardizimin e kërkesave për bazë materiale dhe burime të tjera për vitin pasardhës.

### **Implementimi i Trajnimeve**

Plani vjetor i rritjes së kapaciteteve të INSTAT, për vitin 2018, është ndërtuar mbi identifikimin e nevojave për rritje kapacitetesh gjatë procesit të vlerësimeve të punonjësve. Trajnimet kryesore që do të zhvillohen gjatë 2018 janë:

1. Trajnimet e financuara nga Sida (Mbështetje e Qeverisë Suedeze) në :
  - Menaxhim
  - Metodologjia dhe prodhimi statistikor
  - Teknologji Informacioni
2. Trajnimet e financuara nga IPA 2013, lidhur me :
  - Statistikat e Forcat e punës
  - Diseminimin
  - Statistikat e Bujqësisë
  - Vizita studimore
3. Trajnimet të financuara nga IPA shumëpërfituese 2015
  - Trajnime afatgjata (3.5 dhe 5 mujore) në periudhat:
    - Janar – Qershor 2018
    - Shtator – Dhjetor 2018
  - Programi i kurseve të trajnimeve statistikore evropiane (ESTP).
4. Trajnimet e financuara nga FMN (Joint Viena Institute)
5. Trajnimet e stafit të ri që zhvillohen në INSTAT.
  - Trajnim i përgjithshëm me qëllim njohje me institucionin
  - Trajnime specifike nga drejtoritë me qëllim informimin e stafit të ri me të gjitha proceset, aktivitetet dhe produktet statistikore që prodhohen në INSTAT.
6. Trajnime pranë Qendrës së Trajnimit.

Trajnimet do të zhvillohen për stafin e INSTAT, gjithashtu edhe për përdoruesit e jashtëm të të dhënave, përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike dhe media.

## **Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve**

Misioni kryesor i Drejtorisë së Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve është të kujdeset për ecurinë e përmbushjes së detyrave të INSTAT-it në kuadrin e MSA-së dhe përditësimit të normave ligjore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e prodhimit statistikor, me Acquis të BE-së. Drejtoria ndjek dhe koordinon zbatimin e projekteve të huaja të cilat mbështesin aktivitetet statistikore që mbulon INSTAT-i.

Drejtoria përbëhet nga 3 sektorë dhe një staf prej 10 punonjës, por aktualisht ka 9 punonjës.

Plani i punës për vitin 2018 konsiston në:

1. Zbatimin e Projektit IPA 2013 - gjatë vitit 2018 ky projekt do të jetë në fazën e tij përfundimtare (sipas kontratës përfundon në 5 qershor 2018), ndjekja administrative dhe raportimet periodike.
2. Zbatimin e Projektit SMEI - gjatë vitit 2018 do të kryhen procedurat e prokurimit për blerjen e tabletave dhe për përzgjedhjen e kompanisë (e cila do të kryej punën në terren) si dhe kryerja e anketës.
3. Zbatimin e Projekteve SIDA Faza V- SALSTAT - Banka Botërore (NSDS), ndjekja administrative/raportime për zbatimin e projektit.
4. Zbatimi i programit shumë – përfitues të bashkëpunimit statistikor IPA 2015, ku përfshihet koordinimi i punës me drejtoritë teknike për zbatimin e projekteve pilote si dhe ndjekja dhe zbatimi i aktiviteteve horizontale të organizuara në Eurostat, në Institutet Kombëtare Statistikore, në UNECE dhe OECD.
5. Identifikimi i projekteve që INSTAT mund të aplikojë bazuar në prioritetet e Institucionit dhe aplikimi në projekte të ndryshme.

Drejtoria do të ndjekë rekomandimet mbi Progres Raportin dhe raportimin në kuadër të zbatimit të MSA-së:

1. Raportimet vjetore dhe periodike të Institutit të Statistikave të Komitetit të Stabilizim Associmit KSA, ECOFIN dhe nënkomitete të ndryshme. Raportimi mbi Planin Kombëtar të Integrimit Evropian për të gjitha fushat e statistikave për Kapitullin 18 si dhe organizimi i takimeve mujore të Grupeve Ndër-institucionale të Punës për Statistikat.
2. Koordinimi i punës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me Kryeministrinë si dhe



organizatat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.

3. Koordinimi i punës me agjensitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri si dhe donatorë të tjerë në kuadër të projekteve të ndryshme të cilët mbështetin forcimin e statistikave.
4. Në kuadër të rritjes së vizibilitetit në arenën ndërkombëtare, INSTAT do të organizojë dhe drejtojë për herë të parë seminarin "Përcjellja e mesazheve tona: reflektime strategjike për modernizimin e komunikimit statistikor" në Konferencën e Statisticienëve Evropianë, i cili do të mbahet në datat 18-20 Qershor 2018.
5. Po në këtë kuadër INSTAT në bashkëpunim me EFTA-n dhe Eurostat do të organizojë Seminarin e Menaxhimit Strategjik i cili do të mbahet në datat 5-6 Korrik 2018.
6. Koordinimi i punës me Eurostat mbi pritjen e misionit të vizitës së Eurostat në Shqipëri në si dhe komunikime të tjera në kuadër të përafrimit të statistikave me standardet Evropiane.

Gjithashtu në kuadër të PSZ, Drejtoria do të ndjekë punën për monitorimin e zbatimit nga INSTAT dhe Agjencitë Statistike Zyrtare të objektivave të PSZ për prodhimin statistikor dhe përafrimin e statistikave me Acquis të BE-së.

1. Zbatimi i strukturës së re të raportimit të PSZ i cili do të ketë një format standard raportimi i bazuar në modelet e vendeve të BE-së. Ky raportim do të kryhet çdo 4-mujor të vitit duke pasqyruar situatën e periudhës lidhur me zbatimin e PSZ.
2. Në bashkëpunim me drejtoritë teknike të INSTAT dhe sektorët përkatës të agjencive kombëtare statistikore, do të bëhet përgatitja e strukturës së re të PSZ-së. Do të organizohen takime dhe tryeza të rumbullakëta me të gjithë aktorët e përfshirë në prodhimin e statistikave zyrtare mbi prezantimin e strukturës së re të PSZ 2017-2021.
3. Në bashkëpunim me Drejtorinë e IT, do të ndërtohet aplikacioni i raportimit online bazuar në modelin për mbajtjen dhe raportimin e të dhënave.

Duke synuar një eficiencë më të mirë të punës në INSTAT, do të kryhet monitorimi i të gjithë pyetësorëve dhe koordinimi i punës me drejtoritë teknike për plotësimin dhe dërgimin e tyre në kohë dhe me cilësi.

---

## Kontaktet e institucionit

---



**INSTAT - Instituti i Statistikave**

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë, Shqipëri

**Tel**+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356

**Fax**+(355) 4 2228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

[info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)